Atë që nuk i mëshiron njerëzit, Allahu nuk e mëshiron

Xherir ibën Abdullahu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: "Atë që nuk i mëshiron njerëzit, Allahu nuk e mëshiron."
[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaron se atë që nuk i mëshiron njerëzit, nuk do ta mëshirojë Allahu i Lartmadhëruar. Mëshira që robi e tregon ndaj njerëzve është një nga shkaqet më të mëdha me të cilat fitohet mëshira e Allahut të Lartësuar.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5439